

VENDIM
Nr. 48, datë 15.2.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA PËR SHTYRJEN E AFATIT TË MARRJES NË SHQYRTIM TË KËRKESËS, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s, NR. 169, DATË 3.11.2020, “PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR DHJETËVJEÇAR, 2015 – 2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SHA”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germat “a” dhe “e”, të nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 3, pika 7, germa “a”, të nenit 33, pika 1, të nenit 53, pika 3 dhe neneve 91 dhe 92, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të neneve 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 135, datë 6.9.2017, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 27/4 prot., datë 11.2.2021, të Drejtorive Teknike, mbi kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), për shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 3, datë 15.1.2021, vendosi shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.

- OST sh.a., me shkresën drejtuar në ERE nr. 165/1 prot., datë 9.2.2021, parashtroi se:

- OST sh.a. është në pritje të finalizimit të masterplanit: “Plani mbi investimet dhe zhvillimin e rrjetit për sektorin e transmetimit të energjisë në shqipëri për vitet 2018–2033”, pasi të jenë reflektuar dhe elemente të tjera që mund të dalin nga studimi i masterplanit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- Pavarësisht se procesi i hartimit të këtij dokumenti ka hyrë në fazën përfundimtare dhe angazhimi për dërgimin e draftit final të masterplanit për miratim në ERE ishte brenda muajit janar 2021, për shkaqe të pavarura nga OST sh.a., të imponuara nga masat që janë marrë për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga virusi *COVID-19*, ka qenë e pamundur finalizimi i këtij drafti final, kjo si pasojë e kufizimeve që ka pësuar qoftë kontraktori, qoftë personeli i OST sh.a.

- Një nga risitë e masterplanit është edhe metodologjia e zhvillimit të tij, e cila është zbatuar në studim. Ky trajtim merr në konsideratë të gjithë paketën e investimeve ekzistuese, si dhe zgjerimin, të cilit i përkasin projektet e reja që dalin si rezultat i analizës së rrjetit në projeksion për të ardhmen.

- Për sa parashtruar më sipër, dhe veçanërisht referuar kushteve të ushtrimit të aktivitetit nga personeli i OST sh.a., në mënyrë të kufizuar, si në numër dhe në eficiencë, kërkohet marrja në konsideratë e kërkesës për shtyrje të afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, data 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit

të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”

- Kërkesa e parashtruar nga OST sh.a. ka ardhur brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 3, datë 15.1.2021.

- OST sh.a. është palë me interes të drejtpërdrejtë në këtë proces, në kuptim të parashikimeve të nenit 3, pika 7, germa “a” dhe “b”, si dhe të nenit 33, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe për këtë arsye legjitimohet si palë në këtë procedurë për shkak të interesit të drejtpërdrejtë në këtë vendimarrje.

- Për të analizuar të gjithë elementet e nevojshëm, në mënyrë që të jepet një gjykim dhe argumentim i drejtë, i saktë dhe shterues i kërkesës së parashtruar nga OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, OST sh.a., duhet të paraqesë të gjithë informacionin e kërkuar nga ERE nëpërmjet komunikimeve zyrtare, me qëllim ezaurimin e procedurës administrative dhe marrjen e një vendimi mbi këtë çështje, si dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 53, pika 3 dhe nenet 91 dhe 92, të Kodit të Procedurave Administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për dorëzimin e dokumentacioneve nga ana e shoqërisë OST sh.a., brenda 30 ditëve.

2. Shoqëria OST sh.a. të paraqesë realizimin faktik të investimeve për vitin 2020, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti